

VENDIM
Nr. 69, datë 8.4.2025

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “NAD INVESTMENT” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve të nenit 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e” dhe 13, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 8.4.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1408/1 prot., datë 4.4.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘NAD Investment’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “NAD Investment” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1408 prot., datë 25.3.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pikat 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas germave (“a”, “b” dhe “c”), duke plotësuar formularin sipas formatit të shtojcës 1. Ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, duke plotësuar të dhënat e subjektit, përfshirë emrin, NUIS-in, adresën, kontaktet dhe administratorin. Aplikuesi deklaroi se angazhohet për zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullave të ERE-s dhe ka kryer pagesën e aplikimit më 18.3.2025, sipas aneksit A.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas germave “a”, “b”, “c” dhe “d”. Aplikuesi ka dorëzuar ekstraktin historik të regjistrit tregtar të vulosur elektronikisht nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), më datë 10.3.2025. Nga dokumenti rezulton se shoqëria “NAD Investment” sh.p.k. është regjistruar më datë 18.3.2024, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.). Gjithashtu, aplikuesi ka dorëzuar në ERE vërtetimet e gjendjes gjyqësore të vulosura elektronikisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me nr. kërkesë 11, datë 10.3.2025, nga të cilat rezulton se si administratori i shoqërisë dhe vetë shoqëria, janë të padënuar. Po ashtu aplikuesi ka paraqitur strukturën organizative të shoqërisë e cila është përshtatur për të mbështetur ushtrimin e veprimtarive të tregtimit dhe furnizimit me energji elektrike, për të cilat është paraqitur aplikim në ERE. **Germa “d”** – nuk aplikohet në këtë rast, pasi aplikuesi nuk ka caktuar një përfaqësues ligjor dhe për rrjedhojë nuk ka depozituar akt përfaqësimi.

- Në përputhje me pikën 1.3, të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar në ERE dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas germave “a”, “b” dhe “c”. Sipas germës “a”, janë paraqitur vërtetimet e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, datë 10.3.2025, të cilat konfirmojnë se shoqëria nuk ka detyrime të papaguara ndaj administratës tatimore dhe institucioneve të sigurimeve. Për shkak të regjistrimit të shoqërisë më 18.3.2024 dhe afatit ligjor për dorëzimin e pasqyrave financiare (31.3.2025), këto nuk janë ende të disponueshme. Në vend të tyre, aplikuesi ka paraqitur projeksione mbi sasinë e

energjisë elektrike që parashikon të tregtojë në pesë vitet në vijim, me 6 gwh për vitin e parë, ose 500 mwh në muaj. Mbështetja financiare për një muaj veprimtari është përlogaritur bazuar në çmimin e ALPEX-it për muajin shkurt 2025, dhe për këtë qëllim është dorëzuar një letër interesi nga **Credins Bank** sh.a., datë 7.3.2025, që shpreh gatishmërinë për të mbështetur financiarisht shoqërinë në këtë veprimtari. Gjithashtu, aplikuesi ka paraqitur Planin e Biznesit për periudhën 2025–2030, i cili përfshin analizën e tregut për vitet 2021–2024 dhe parashikime për kostot, të ardhurat, shitjet dhe burimet e financimit për pesë vitet e ardhshme.

- Në përputhje me pikën 2.5 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Shoqëria ka paraqitur në ERE parashikimin e sasisë së energjisë elektrike që synon të tregtojë gjatë pesë viteve të vlefshmërisë së licencës.

- Shoqëria rezulton ka kryer pagesën e tarifës së aplikimit, në përputhje me përcaktimet e aneksit A të rregullores.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “NAD Investment” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “NAD Investment” sh.p.k. dhe për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti